




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 77/2 prot.

Tiranë, më 12.02.2024

MIRATOHET

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT
DREJTUES MADHOR MUHAMET RRUMBULLAKU



PROGRAM VJETOR I PUNËS

I

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

PËR VITIN 2024

Tiranë, 2024

I. VLERËSIMI I SITUATËS EKZISTUESE.

Policia e Shtetit për vitin 2023 ka patur në qendër të vëmendjes, realizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike të përcaktuara në Politikat Prioritare në Fushën e Rendit e Sigurisë, Programin Vjetor të Punës për vitin 2023, në Strategjinë Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim, Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 dhe në Strategjitë e tjera Ndërsektoriale e Sektoriale.

Nga analizat e punës në strukturat qendrore e vendore të Policisë, evidentohet fakti se Policia e Shtetit ka përmbushur detyrat institucionale e ligjore për respektimin e lirive e të drejtave të individit, ruajtjen e rendit publik, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, rritjen e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, parandalimin e goditjen e krimit ndërkufitar, duke përfutur një përvojë pozitive për menaxhimin më të mirë të situatës së rendit e sigurisë publike, fatkeqësive natyrore dhe aktiviteteve të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare.

Masat efektive për realizimin e Prioriteteve dhe Objektivave Strategjike të vendosura në Programin Vjetor të Punës së PSH për vitin 2023, kanë bërë të mundur realizimin e arritjeve në:

- Zhvillimin e organizatës së policisë nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor e nënligjor, për ta përafuar me standardet e strukturave simotra të vendeve të Bashkimit Evropian.
- Forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit, krimit kibernetik, terrorizmit e krimeve të rënda nëpërmjet koordinimit ndërinstytucional, zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve hetimore, rritjes së numrit të hetimeve proaktive, shkëmbimit të informacionit dhe organizimit të operacioneve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë.
- Forcimin e rendit e sigurisë publike, garantimin e lirive e të drejtave të njeriut nëpërmjet shërbimeve të sigurisë për kontrollin e territorit, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, reduktimin e krimit të rrogës e dhunës në familje, parandalimin e aksidenteve rrugore dhe rritjen e besimit të publikut tek policia.
- Rritjen e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, forcimin e kapaciteteve teknike e hetimore, zhvillimin e strukturave operuese, menaxhimin e flukseve migratore sipas standardeve të BE, rritjen e cilësisë së nivelit profesional të punonjësve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për migracionin dhe kufirin.
- Përmirësimin e nivelit shkollimit e trajnimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, logjistike e financiare, rritjen e kapaciteteve të menaxhimit strategjik të Policisë dhe përmirësimin e politikave e procedurave në përshtatje me ndryshimet e reja strukturore e ligjore.
- Përmirësimin e performancës të Organizatës së Policisë nëpërmjet standardizimit të procedurave të punës e statistikave dhe zbatimin rigoroz të akteve ligjore e nënligjore lidhur me informacionin e klasifikuar dhe sigurinë.
- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore, pushtetit vendor, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe shoqërinë civile, për zbatimin e ligjshmërisë, garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive të qytetarëve.
- Zhvillimin e bashkëpunimit intensiv me partnerët ndërkombëtarë, INTERPOL, EUROPOL, FRONTEX, etj dhe plotësimin e detyrimeve të ndërsjellta me vendet partnere të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2023, janë trajtuar: 34 projekt-ligje; 48 projekt-vendime; 22 akte normative (urdhra e udhëzime); 42 projekt-marrëveshje, projekt-protokolle, projekt-momerandume, me partnerë vendas e të huaj dhe u përgatitën 60 procedura standarde dhe përshkrimet e punës për 58 funksione organike të strukturave të Policisë së Shtetit.

Miratimi i këtyre dokumenteve ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së punës dhe në evidentimin e përgjegjësive të çdo punonjësi për përmbushjen e rregullt të detyrës.

- C. Vepra penale në fushën e korrupsionit.**
- U evidentuan 928 vepra, u zbuluan 830, ose 89.4 %. Krahasuar me 2022, u evidentuan 264 vepra më pak ose -22.1 %.
- D. Vepra penale në fushën Ekonomiko- financiare.**
- U evidentuan 3401 vepra, u zbuluan 3268, ose 96.1 % tyre. Krahasuar me 2022, u evidentuan 847 vepra më pak ose -19.7 %.
- E. Vepra penale në fushën e pastrimit të parave.**
- U evidentuan 551 vepra, u zbuluan 533, ose 96.7 % tyre. Në krahasim me 2022 janë evidentuar 48 vepra më pak ose -8 %.
- F. Vepra penale në fushën e Akteve terroriste.**
- U evidentuan 38 vepra, u zbuluan 28 ose 73.68 %. Në krahasim me 2022 u evidentua 1 vepër më pak.
- G. Vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike.**
- U evidentuan 765 vepra, u zbuluan 413, ose 54 %. Krahasuar me 2022 u evidentuan 220 vepra më shumë ose +40.4%.
- H. Vepra penale në fushën e narkotikëve.**
- U evidentuan 2444 vepra, u zbuluan 2403, ose 98.3 %. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar u evidentuan 12 vepra më pak ose 0.5 % më pak.
- I. Vepra penale në fushën e trafikëve të pa ligjshme.**
- U evidentuan 1215 vepra, u zbuluan 1203, ose 99 %. Krahasuar me 2022, u evidentuan 126 vepra më pak, prej të cilave :
 - Nga Departamenti i Policisë Kriminale u evidentuan 537 vepra, u zbuluan 531, ose 98.98%. Krahasuar me vitin 2022 janë 75 vepra më pak ose -12.3 %.
 - Nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin u evidentuan 678 vepra kundër personit, u zbuluan 672, ose 99.11%. Krahasuar me vitin 2022 janë 51 vepra më pak ose -7.5 %.
- J. Vepra penale të kryera nga Grup i Strukturuar Kriminal.**
- U evidentuan 53 vepra, u zbuluan 47, ose 89 %. Krahasuar me 2022, u evidentua 3 vepra më pak ose -5 %.
- K. Vepra penale të tjera. (armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit, kundër pasurisë dhe sferës ekonomike)**
- U evidentuan 6477 vepra, u zbuluan 6351, ose 98.1 %. Krahasuar me 2022, u evidentuan 713 vepra më shumë ose +12.4 %.
- L. Vepra penale të dhunës në familje.**
- U evidentuan 5064 vepra, u zbuluan 100 % tyre, prej të cilave:
 - Referuar në Prokurori 2233 raste, nga të cilat janë zbuluar 99.8 % tyre.
 - Trajtuar me *kërkesë-padi* "Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes", 2730 raste të dhunës në familje.
 - Vepra të tjera 101 raste.
 - Nga vrasjet e ndodhura, 11 raste janë në familje, 1 më shumë se vitin e kaluar;
 - Në krahasim me 2022 janë 135 raste më pak ose -2.8%.
- M. Vepra penale kundër mjedisit.**
- U evidentuan 518 vepra, u zbuluan 507, ose 97.9%. Krahasuar me 2022, janë 53 më pak ose -9.3%.
- N. Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.**
- U evidentuan 5548 vepra penale, u zbuluan 5447, ose 98.2%. Krahasuar me 2022, janë 132 më pak ose -2.3%.
- O. Hetimet Proaktive**
- Janë ndjekur 1380 hetime proaktive. Krahasuar me 2022 janë 169 hetime më pak ose -11%.

U garantua rendit publik dhe u rrit sigurisa rrugore në plazhet e zonat turistike, duke përmbushur me sukses detyrat për parandalimin e veprimtarisë kriminale, ruajtjen e jetës, pronës publike e private dhe menaxhimin e trafikut rrugor në akset rrugore kryesore dhe ato që lidhen me plazhet e zonat turistike.

Bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021- 2026 dhe Plani i Veprimit 2021-2023, janë ndjekur detyrimet për forcimin e policimit në komunitet, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, ri-integrimin e personave të kthyer nga Siria dhe Iraku, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, ndjekjen e aktiviteteve sensibilizuese me shkollat, bashkëpunimin me strukturat shtetërore, qeverisjen vendore, OJF, misionet dhe programet ndërkombëtare.

- Telefonata nga publiku janë regjistruar 1192395 ose 13% më pak se në 2022.
- Në portalin "Komisariati Dixhital", nuk janë evidentuar njoftime nga publiku, pasi ky shërbim nuk funksionon që nga data 14.07.2022.
- Aksidente rrugore me pasoja të rënda u evidentuan 387 raste, 12 më shumë ose +3 % se në 2022.
- Për menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme për sigurimin e rendit publik, janë kryer 4788 shërbime, 894 raste më shumë ose +22.9 % se në 2022.

❖ BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- Gjatë vitit 2023 në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë shkëmbyer nga Interpol, Oficerët Ndërlidhës dhe Europol 29118 informacione me zyrat partnere Europol, Interpol dhe Oficerët Ndërlidhës, duke shënuar një ulje me 1323 informacione ose -4.3 % më pak se në 2022.
- Janë koordinuar nga Interpol, Europol dhe Oficerët e Kontaktit 148 operacione policore, 32 operacione më shumë ose +27.6% se në 2022.
- U arrestuan për qëllime ekstradimi drejt vendit tonë dhe drejt vendeve të tjera 232 persona. Krahasuar me 2022 u arrestuan 60 persona më shumë, ose +34.8 %.

❖ MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

Aktivitete kryesore të kryera në 6 mujorin e parë 2023:

- Në Pikat e Kalimi e Kufitar janë përpunuar në Hyrje – Dalje 33.685.793 shtetas shqiptarë e të huaj, ose +15.6 % me shumë se 2022.
- Janë përpunuar në Pikat e Kalimi e Kufitar në Hyrje – Dalje 9.770.254 automjete shqiptare e të huaja, ose +16 % më shumë se 2022.
- Janë sekuestruar 91 dokumente udhëtim (37 pasaporta, 19 karta identiteti, 17 leje qëndrimi) ose -17 % më pak se 2022..
- Janë kapur 555 shtetas në kërkim (395 në kërkim kombëtar, 29 në kërkim ndërkombëtar dhe 131 në kërkim për llogari të Kosovës) ose 56 shtetas më shumë se 2022.
- Janë Refuzuar në Dalje, për shkak se nuk plotësojnë kushtet për të udhëtuar drejt zonës Schengen 7521 shtetas shqiptar (610 të mitur dhe 6911 të rritur) ose +8.1 % se 2022.
- Janë kthyer INAD 7071 shtetas shqiptar ose 67 më shumë se 2022 dhe janë Deportuar 8241 shtetas për shkelje të rregullave të qëndrimit në zonën Schengen ose 814 më shumë se në 2022.
- Janë evidentuar 1192 ngjarje, 120 më shumë se 2022 ose +14 %.
- Janë kapur 268 shtetas shqiptar në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit ose 104 më pak se 2022.
- Janë kryer 1.125 patrullime të përbashkëta me vendet fqinje, 701 me kufirin tokësor dhe 424 me kufirin detar. Krahasuar me vitin e kaluar u kryen 149 patrullime më shumë, ose +15 %.
- Janë kapur 6623 shtetas të huaj imigrantë të parregullit. Krahasuar me 2022, u kapën 5.301 shtetas më pak ose -44 %.

- Janë kryer nga donatorët 279 trajnime, me pjesmarrës 5671 punonjës policie.

b) Personeli:

- Janë bërë 14,027 praktika për nevojat e dinamikës së personelit.
- Janë plotësuar 227 praktika (dosje të veçanta) për familjet e punonjësve të rënë në krye të detyrës.
- Janë përgatitur 226 praktika për ndihmë financiare familjeve të punonjësve të rënë në krye të detyrës.
- Largim nga puna 736 punonjës, nga të cilat; Lirime 640 praktika, Përfundime 96 praktika.

c) Disiplina:

Janë hetuar e verifikuar gjithsej 682 punonjës:

- Janë ndëshkuar 367 punonjës për shkelje të rëndë disiplinore: Përfunduar 84 punonjës, Shtyrje e afatit të gradimit 260 punonjës, dhe për 7 punonjës ulje në gradë për një periudhë 6 muaj.
- Janë ndëshkuar 250 punonjës për shkelje të lehtë disiplinore.
- Janë ndëshkuar 35 punonjës me masë parandaluese "Tërheqje vëmendje" ose "Këshillim".
- Ka përfunduar hetimi disiplinor për 30 punonjës.
- Janë pezulluar disiplinarisht nga detyra 207 punonjës.
- Janë regjistruar e janë trajtuar 742 ankesa, 532 të Platformës, Zyra e Bashkëqeverisjes, Kryeministria.
- Janë realizuar 240 vlerësime të performancës e monitorime, prej të cilave:
 1. 55 vlerësime të planifikuara dhe monitorime procesesh rekrutimi, 2 më shumë se në vitin 2022;
 2. 119 vlerësime të paplanifikuara, 11 më shumë se në vitin 2022;

d) Financat, teknologjia e informacionit dhe logjistika:

- Fondet buxhetore brenda limitit të miratuar për Programin "Policia e Shtetit" realizimi i pritshëm në shumën 21,410,2950 mijë lekë, 3,132,200 mije lekë më shumë se viti 2022, ose +17 %.
- Shpenzimet për investime në vitin 2023 realizimi i pritshëm në shumën 1,422,849 mijë lekë, krahasuar me vitin 2022 janë ulur 92,129 mije lekë, ose -6%.
- Fondet buxhetore brenda limitit të miratuar për Programin "Policia e Shtetit", pritet të realizohen në shumën 21,410,295 mijë lekë, nga 21,523,125 mijë lekë të planifikuara, ose 99 % e planit.
- Sigurimi i trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit (përfshirë edhe orët jashtë orarit dhe orë nate dhe dietat) në masën 100 %.
- Të ardhurat mujore neto për një punonjës për vitin 2023, krahasuar me 2022, u rritën +13,5 %.
- Janë furnizuar punonjësit e Policisë me uniformë 100%.
- Janë realizuar fondet e planifikuara për investime të brendshme 99.8 % të planit.
- Projektet e investimeve të parashikuara për mirëmbajtjen, përmirësimin e zgjerimin e sistemeve e pajisjeve të teknologjisë së informacionit janë realizuar 100 %.
- Janë kryer punimet për rikonstruksionin apo ndërtimin e objekteve të reja për 7 projekte, në vlerën 450,271 mije lekë, kryesisht në rikonstruksionin apo ndërtim të objekteve të reja, në DVP Elbasan, DVP Berat dhe Komisariati i Policisë Sarandë, dhe përfunduan punimet për ndërtimin dhe rikonstruksionin në DVP Dibër; Blloku Antenave Fushe-Dajt; rikonstruksionin e Sallave Operative NUE 112 në DVP Durrës; Fier; Gjirokastër dhe Kom. Pol. Sarandë.
- Janë prokuruar ose realizuar fondet për blerjen e pajisjeve të Policisë kriminale në shumën 174,420 mijë/lekë, automjete e mjete lundruese për Policinë Kufitare 104,133 mijë/lekë.
- Janë realizuar fondet për blerjen e pajisjeve kompjuterike në shumën 80,889 mijë/lekë.
- Financimet e Huaja u planifikuan 453,077 mijë lekë dhe u realizuan 356,199 mijë lekë ose 79% e planit vjetor.
- Janë përfituar sponsorizime nga donatore vendas e të huaj 197,109,550 lekë.
- Nga njësitë shpenzuese në varësi të Programit "Policia e Shtetit", arkëtimi i pritshëm i të ardhurave në shumën 3,067,667 mije lekë.
- Janë në proces punimet për mirëmbajtjen, zgjerimin apo ndërtimin e sistemeve të transmetimit të informacionit për: Numrin e Emergjencave 112, Pajisje Kompjuterike, Mirëmbajtje për rrjetin kompjuterik, projekte në vlerë 114,474 mijë/lekë.

Për këtë prioritet do realizohen objektivat si më poshtë:

1. **Rritja e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Policisë Kriminale.**
 - a) Rritja e aftësive profesionale të punonjësve të Departamentit të Policisë Kriminale dhe strukturave vendore të varësisë lëndore.
 - b) Zhvillimi i kapaciteteve logjistike për Policinë Kriminale.
2. **Ulja e kërcënimit dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar**
 - a) Hetimi dhe ndjekja penale e drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale.
 - b) Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve.
 - c) Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e trafikeve të paligjshme.
 - d) Goditja e krimit ekonomik, pastrimit të parave, korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.
 - e) Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar.
3. **Rritja e forcës parandaluese e ndëshkuese kundër krimeve të rënda ndaj personit e pasurisë.**
 - a) Parandalimi, zbulimi dhe dokumentimi ligjor i krimeve të rënda ndaj personit e pasurisë.
 - b) Kapja e personave në kërkim kombëtar e ndërkombëtar.
4. **Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.**
 - a) Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional.
 - b) Përmirësimi i bazës ligjore duke synuar miratimin e projektudhëzimeve të përbashkëta me Institucionet Ligjzbatuese dhe ato të drejtësisë.
5. **Policimi i udhëhequr nga inteligjenca.**
 - a) Përmirësimi i procedurave të punës në kuadër të policimit të udhëhequr nga inteligjenca.
 - b) Rritja e performancës së Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale në funksion të hetimeve.
 - c) Përdorimi efektiv i sistemit të menaxhimit të informacionit policor (SMIP).
 - d) Rritja efektivitetit të punës së Policisë Kriminale në funksion të policimit, udhëhequr nga inteligjenca.
6. **Garantimi i hetimit për krimet kibernetike dhe krimet e lidhura me provat elektronike në nivel kombëtar.**
 - a) Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e krimeve kibernetike.
 - b) Përmirësimi i mbledhjes së informacionit për të luftuar krimin kibernetik e krimet e lidhura me to.
 - c) Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për krimet kibernetike dhe krimet e lidhura me to.
 - d) Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin, ndjekjen dhe goditjen e krimeve kibernetike ndaj fëmijëve në internet.
 - e) Hetimi efektiv dhe vënia para drejtësisë e autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve, me fokus abuzimin dhe shfrytëzimin seksual.

Indikatorë të matshëm:

Indikatorët në vijim, në pjesën më të madhe të tyre janë të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2023-2025, miratuar me VKM nr.1140, datë 24.12.2020, ndryshuar me VKM nr.54 datë 01.02.2023, realizimi i të cilëve është detyrim për gjithë strukturat policore, që në zbatim të urdhrat nr.974, datë 29.06.2023, të DPPSH, "Për përcaktimin e veprave penale, objekt i punës në strukturat e Policisë së Shtetit", kanë objekt pune nënet e Kodit Penal sipas të cilave janë përlllogaritur indikatorët.

- Rritja 1% e evidentimit të veprave penale në fushën e narkotikëve në krahasim me vitin 2020 (2128 vepra penale në vitin 2020).
- Realizimi i zbulueshmërisë së veprave penale në fushën e narkotikëve jo më pak se 88%.
- Rritja 3% e sasive të sekuestruara të heroinës, krahasuar me mesataren e sasive të sekuestruara në peirudhën 2016-2020 (43.2 kg heroinë).
- Rritja 3% e sasive të sekuestruara të kokainës, krahasuar me ato të sekuestruara në vitin 2020 (5.9 kg kokainë në vitin 2020).
- Rritja 4 % e numrit të grupeve kriminale të godituara, krahasuar me vitin 2019 (43 grupe ne 2019).

- a) Reagimi i shpejtë sipas protokolleve ndërkombëtare ndaj incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE).
 - b) Reduktimi i rreziqeve nëpërmjet monitorimit që rrjedhin nga transferimet dhe transportimi i materialeve radioaktive që mund të përdoren për të kryer sulme apo akte terroriste.
- 4. Përmbajtja terroriste online.**
- a) Rritja e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë darknet-in.
 - b) Shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimi me partnerët rajonale dhe ndërkombëtar për përmbajtjet terroriste online.

Prioritet III: Krijimi i një mjedisi sa më të sigurt për komunitetin, për mbrojtjen e jetës e pronës duke ofruar shërbime, në bashkëpunim të ngushtë me gjithë aktorët në fushën e sigurisë publike, komunitetin dhe subjektet e tjera publike e private.

Për këtë prioritet do realizohen objektivat si më poshtë:

- 1. Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet.**
 - a) Evidentimin, parandalimin dhe trajtimin në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që çenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet.
 - b) Parandalim i shkeljeve të ligjit që rrezikojn të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve nëpërmjet finalizimi të procesit Screening për Kapitullin 23 dhe 24.
 - c) Identifikimi i Ligjeve, udhëzimeve dhe procedurave të tjera kombëtare që janë të ndryshme nga legjislacioni eksiztues i BE-së, me qëllim përafrimin e tyre sipas standardeve të BE.
- 2. Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin.**
 - a) Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin.
 - b) Përmirësimin e komunikimit me publikun për çështje të sigurisë në komunitet, nëpërmjet edukimit dhe sensibilizimit.
- 3. Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet.**
 - a) Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë.
 - b) Ofrimi i shërbimeve të ruajtjes rendit e sigurisë publike ndaj komunitetit, parandalimi i veprimtarisë kriminale në teritor dhe garantimi i rendit publik në aktivitetet me karakter masiv dhe gjatë sezonit turistik gjithë vjetor.
- 4. Rritja e parametrave të Sigurisë Rrugore.**
 - a) Ndërgjegjësimi dhe komunikimi me publikun për sigurinë rrugore.
 - b) Teknologjia në shërbim të sigurisë rrugore, digjitalizimi i shërbimit të Policisë Rrugore.
 - c) Hartimi i projektligjeve dhe akteve normative në harmoni me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.
 - d) Bashkëpunimi ndërinstytucional për sigurinë rrugore.
- 5. Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga armët, eksplozivët dhe fishekzjarrët që cenojnë sigurinë dhe rendin publik.**
 - a) Harmonizimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, eksplozivëve dhe fishekzjarrëve të harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së.
 - b) Ulja e rrezikut të përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.
 - c) Rritja e efektivitetit të shërbimit privat të sigurisë, në qëllim të mbrojtjes së jetës, pronës e veprimtarive social-kulturore në vend.
 - d) Ofrimi i një kuadri më të mirë rregullator për veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike.
- 6. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit në fushën e kultivimit të bimëve narkotike.**
 - a) Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike.
- 7. Rritja e forcës parandaluese e ndëshkuese kundër krimeve në familje. Trajtimi sa më profesional i të miturve në kontakt me policinë.**

- b) Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë përmes finalizimit të marrëveshjeve, protokolleve, dhe realizimit të takimeve dy apo shumë palëshe.
- 2. **Rritja e kapaciteteve të Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, përmes përmirësimit të marrëdhënieve ndër-institucionale.**
 - a) Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet ligjzbatuese brenda vendit.
 - b) Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ligjzbatuese nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve apo udhëzimeve të përbashkëta, që i shërbejnë arritjes së qëllimit të luftës kundër kriminalitetit .
- 3. **Propozimi i ndryshimeve ligjore e nënligjore për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional.**
 - a) Përmirësimi i bazës ligjore duke synuar miratimin e udhëzimeve të përbashkëta me institucionet ligjzbatuese dhe ato të drejtësisë.
 - b) Rritja e kapaciteteve të strukturave nëpërmjet përmirësimit të procedurave, urdhrave e udhëzimeve, që lidhen me aktivitetin e strukturave të DMN, në përputhje me strukturën e re, si dhe miratimi i Rregullave dhe Procedurave të Veprimitarisë së Drejtorisë së Interpolit dhe Drejtorisë së Europol-it.
- 4. **Ndjekja dhe plotësimi i gjithë detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit të vendit në BE.**
 - a) Përgatitja dhe përkthimin e kontributeve të PSH në kuadër të Progres Raporteve për Shqipërinë dhe Takimeve të KSA-së dhe JFS-së, si raportimi për progresin e PSH në zbatim të rekomandimeve afatshkurtra të Progres Raporteve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, Nënkomiteteve dhe grupeve të punës për kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”; Kapitulli 7 “E drejta e Pronësisë Intelektuale” dhe Kapitulli 4 “Lëvizja e Lirë e Kapitaleve”.
- 5. **Forcimi i bashkëpunimit me EUROPOL, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në prioritetet e EMPACT-it, si dhe Projektet Analitike të EUROPOL-it;**
 - a) Forcimi i bashkëpunimit me EUROPOL, rritja e angazhimit në Projektet Analitike të Europol-it, nëpërmjet rritjes së produktivitetit të Oficerëve Ndërlidhës, dhe pikave të kontaktit për Projektet Analitike.
 - b) Forcimi i bashkëpunimit me EUROPOL, rritja e angazhimeve në kuadër të prioriteteve të EMPACT-it, nëpërmjet rritjes së aktivitetit të Pikave të Kontaktit për prioritetet e EMPACT, për vitet 2024-2025.
- 6. **Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimi i kushteve të punës e teknologjisë, sipas standardeve evropiane.**
 - a) Përmirësimi i kushteve të punës, teknologjisë, infrastrukturës dhe sistemeve informatike sipas standardeve evropiane, duke synuar:
 - b) Jetësimin e sistemit të INTERPOL Interpol Web Service for Data Management (ISDM dhe shërbimin WISDM), në sistemin TIMS të Policisë së Shtetit.
 - c) Përditësimi i sistemit FIND të INTERPOL-it, i cili është inkorporuar në sistemin TIMS, që nga viti 2009, në versionin FIND 0.4.
 - d) Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, për identifikimin e kandidatave të përshtatshme dhe rritjen e kapaciteteve të strukturave të DMN-së.
 - e) Zgjerimi i përfaqësimit të Policisë së Shtetit në vendet e tjera të BE-së.

Prioritet VI: Zhvillimi dhe përafrimi i standardeve të organizatës së policisë me ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- 1. **Përdorimi eficient dhe ekonomik i burimeve financiare, administrimi i saktë të vlerave materiale e monetare, si dhe parandalimi i shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.**
 - a) Detajimi i buxhetit të akorduar për Programin Buxhetor “Policia e Shtetit”, bazuar në Ligjin nr. 97, datë 07.12.2023 “Për Buxhetin e vitit 2024” dhe vitet 2025-2026.

- c) Të hartohen kërkesat për implementimin e sistemit elektronik të Menaxhimit të Burimeve.
 - d) Të monitorohet zbatimi projekteve me financim të huaj sipas planit të miratuar për vitin 2024.
 - e) Të përfundojë studimi për mjetet me qira operationale.
 - f) Të realizohet projekti pilot në QFMT për aplikimin e sistemit Barcod në menaxhimin e aktiveve të shërbimit të armatimit.
 - g) Të përfundojë vlerësimi me çmime i aktiveve të shërbimit të armatimit dhe pajisjeve speciale dhe të pasqyrohet vlera në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, për çdo njësi shpenzuese.
- 6. Përafrimi i legjislacionit me acquis communautaire të BE.**
- a) Pjesëmarrja në grupet e punës për përafrimin e legjislacionit, parashikuar në PPAP miratuar me VKM nr. 790, dt. 28.12.2023, dhe PKIE miratuar me VKM nr. 16, datë 11.01.2024.

Prioritet VII: Transformimi i Akademisë së Sigurisë dhe Zhvillimi Institutit të Policisë Shkencore, përafrimi i legjislacionit aktual dhe realizimi i detyrimeve të IPSH-së që rrjedhin nga direktivat e BE-së.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- 1. Arsimim cilësor i strukturave të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese përgjatë vitit 2024”, nëpërmjet rritjes së standarteve akademike të mësimdhënies dhe përmirësimit të programeve mësimore që zhvillohen në Akademinë e Sigurisë”**
 - a) Respektim i kërkesave të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
 - b) Vazhdimi i procesit të akreditimit të programeve të Akademisë së Sigurisë.
 - c) Rritja e njohurive profesionale të punonjësve të strukturave të policisë së shtetit, nëpërmjet shkollimit, specializimit dhe trajnimit të vazhduar të të gjitha niveleve.
 - d) Forcimi i bashkëpunimit me universitetet brenda vendit, si dhe bashkëpunimin rajonal, në fushën e arsimimit policor.
- 2. Zhvillimi IPSH-së, përafrimi i legjislacionit aktual dhe realizimi i detyrimeve të IPSH-së që rrjedhin nga direktivat e BE-së.**
 - a) Realizimi i detyrimeve që burojnë nga kapitulli 24 i KE-se “*Siguria drejtësia dhe liria*”, Vendimi Kuadër i KE-se 2009/905/JHA 30 Nëntor 2009 dhe Vendimi i KE 2002/188 /JHA /2002.
 - b) Rishikimi i kuadrit ligjor në funksion të ristrukturimit të IPSH-së dhe laboratorëve policisë shkencore në DVP në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore.
 - c) Rritja e kapaciteteve shkencore në të gjitha e ekzaminimeve kriminalistike.
- 3. Akreditimi i IPSH-së dhe implementimi i standardit EN ISO/IEC 17025.**
 - a) Implementimi i standardit EN ISO/IEC 17025 dhe nxjerrja e akteve normative për nisjen e Procesit të Akreditimit.
 - b) Modernizimi i Sektorit të menaxhimit dhe administrimit të provave materiale.
 - c) Sigurimi i një godine të përshtatshme për akomodimin e IPSH-se sipas standardeve ISO 17025.
 - d) Rritja e kapaciteteve teknike e profesionale për strukturat e Policisë Shkencore.
- 4. Anëtarësimin e Institutit të Policisë Shkencore në rrjetin Evropian të Instituteve të Policisë Shkencore “ENFSI”.**
 - a) Krijimi i produkteve të besueshme me cilësi dhe për shkëmbimin e të dhënave me vendet e rajonit dhe të BE-së.

Prioritet VIII: Përmirësimi sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Policinë e Shtetit.

(Nëpërmjet përmirësimit i kushteve të punës e teknologjisë, mirëmbajtjes dhe përmirësimit i menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit për garantimin e sigurisë së shërbimeve dhe cilësisë së komunikimit e transmetimit të informacionit, si dhe zbatimit të projekteve të miratuara e planeve afat gjata në modernizimin e sistemeve dhe pajisjeve).

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- 1. Përmirësimi i kushteve të punës dhe teknologjisë.**

- f) Hartimi i termave të referencës për projektin e menaxhimit të të dhënave të Burimeve Njerëzore dhe Implementimi i sistemit PRIMIS.
- g) Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të burimeve njerëzore.
- 4. Përmirësimi i organizimit strukturor dhe trajtimi/përfitim i financiar, moral dhe mjekësor të punonjësve gjatë qëndrimit në punë dhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
 - a) Përputhja e strukturave organike të Policisë së Shtetit me ato të Policive të vendeve të BE-së.
 - b) Rritja e motivimit të punonjësve të policisë nëpërmjet përmirësimit të trajtimit me pagë.
 - c) Ofrimi i një shërbimi sa më cilësor për ish punonjësit e policisë përfitues të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pensionit suplementar të pleqërisë.
 - d) Rritja e për kujdesit ndaj familjeve të punonjësve të policisë të rënë në krye apo për shkak të detyrës.
 - e) Dhënia e stimujve moral e financiar për punonjësit e dalluar të Policisë së Shtetit.
 - f) Trajtimi financiar dhe moral i punonjësve të policisë gjatë qëndrimit në punë dhe pas ndërprerjes së punës.
 - g) Realizimi i një procesi sa më transparentë të përfimit të kredive lehtësuese për blerje banese.
 - h) Ofrimi i shërbimi mjekësor sa më cilësor ndaj punonjësve të policisë.
 - i) Ndjekja dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore të punonjësve dhe adresimi i problemeve të tyre në instancat përgjegjëse.
- 5. Parandalimi i konfliktit të interesave dhe mirë administrimi i dokumentacionit të personelit
 - a) Menaxhimit i procesit të deklarimit të interesave private të subjekteve deklaruese në Policinë e Shtetit.
 - b) Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga procedurat standarde të punës, për Sektorin e Kartotekës dhe Arkivit, administrimi i dokumenteve të Personelit.
 - c) Menaxhimi i procesit të vetingut, referuar ligjit nr.12/2018, i ndryshuar me ligjin nr.78/2022 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesa".
- 6. Aplikimin e metodave apo formave më efikase në interes të rritjes së imazhit të policisë në komunitet si dhe të reagimit më të shpejtë në media për situata apo operacione policore.
 - a) Rritja e imazhit të policisë në komunitet, si dhe të reagimit më të shpejtë në media për situata apo operacione policore.
- 7. Promovim i vlerave dhe imazhit të Policisë së Shtetit në publik dhe promovimi i kontributit të përfaqësuesve të policive partnere në vendin tonë.
 - a) Promovim i imazhit të PSH tek partneret ndërkombëtar dhe publikut nëpërmjet organizimit të konferencave, takimeve dypalëshe apo shumëpalëshe, brenda dhe jashtë vendit.
 - b) Promovim i vlerave dhe kontributit të dhënë nga punonjësit e policisë dhe nga përfaqësuesit e policive partnere në vendin tonë.

Prioritet X: Ndjekja procesit të integritetit të vendit tonë në BE, planifikimi dhe analiza strategjike, përpunimi e mbrojtja e të dhënave, planifikimi i trajnimeve dhe zhvillimi profesional i punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- 1. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave në sistemet elektronike, standardizimi i statistikave të kriminalitetit, sipas standardeve evropiane.
 - a) Përafrimi kombëtar dhe ndërkombëtar për standardizimin e institucionalizimin dhe përmirësimin e programit të statistikave të kriminalitetit.
 - b) Prodhim i statistikave të sakta e të besueshme. Përmirësim në aplikacionin Komunikata Ditore" për statistikave të kriminalitetit.
 - c) Përmirësimi i rolit të Sekretariatit dhe Arkivit. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga procedurat standarde të punës për Sekretari-Arkivat dhe nga aktet ligjore e nën ligjore.
 - d) Siguria fizike e informacionit dhe siguria e personelit në Policinë e Shtetit.
 - e) Përpunimi i ligjshëm, përdorimi dhe mbrojtja e të dhënave në sistemet elektronike.

Përdoruesve të Policisë së Shtetit		5. Përmirësim i aplikacionit Raporte Statistika në varësi të kërkesave nga strukturat përfituese.	DTI				X
		6. Përmirësim i aplikacionit mbi Lejet Lokale të Kufirit në varësi të kërkesave nga strukturat përfituese.	DTI				X
		7. Ngritja e tëbesëservice-ve për ndërveprimin e sistemit TIMS me sisteme të tjera elektronike.	DTI				X
		8. Ngritja e tëbesëservice-ve për ndërveprimin e të dhënave të sistemit RIMS me sistemin e AMP.	DTI				X
		9. Përmirësim i aplikacionit ASPEDS-RMIS për sinkronizimin e të dhënave.	DTI				X
VII-4. Prioritet Specific: Zgjerimin e njohurive për punonjësit e rinj në lidhje me komunikimin edhe përdorimin e aplikacioneve të IT.							
Nr.	Objektivat	Masa dhe aktivitetet	Struktura / zbatuese	3M	6M	9M	12M
1	Zgjerimin e njohurive për punonjësit e rinj.	<ol style="list-style-type: none"> Asistimi, mbikqyrja dhe menaxhimi i aktiviteve që lidhen me vlerësimin në mënyrë periodike të nevojave për trajnim në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Monitorimi për menyrën e përdorimit të sistemeve nga përdoruesit fundorë në Policinë e Shtetit, si edhe përgatitja e raporteve mbi performancën e tyre. Organizimi i trajnimeve të ndryshme në funksion të nevojave të paraqitura. 	DTI				X
VIII. PRIORITET STRATEGJIK: Transformimi i Akademisë së Sigurisë dhe Zhvillimi Institutit të Policisë Shtetërore, përafrimi i legjislacionit aktual dhe realizimi i detyrimeve të IPSH-së që rrjedhin nga drektivat e BE-së.							
VIII-1. Prioritet Specific: Arsimim cilësor i strukturave të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese përgjatë vitit 2024*, nëpërmjet rritjes së standardeve akademike të mësimit dhe përmirësimit të programeve mësimore që zhvillohen në AS*.							
Nr.	Objektivat	Masa dhe aktivitetet	Struktura / zbatuese	3M	6M	9M	12M
1	Respektim i kërkesave të Ligjit "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".	<ol style="list-style-type: none"> Rivlerësimi i përshatshmërisë së disa përcaktimeve të VKM nr. 881, datë 30.10.2019, në përshatje me ndryshimet strukturore të Policisë së Shtetit, me nr. 5449/6 date 26.10.2022 dhe ligjit të ri të Policisë së Shtetit. Përditësimi i vazhdueshëm i programit "Bachelor" dhe rishikimi i programit të shkollimit bazë policor "Parullë e Përgjithshme", në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Komizës Shqiptare të Kualifikimeve. Organizimi i një fushate promovuese dhe informuese me nxënësit maturantë dhe grupeve të tjera të interesit, në disa nga shkollat e mesme të vendit, me programet dhe kurrikulat që ofron Akademia e Sigurisë, me qëllim nxijen e interesit të tyre për t'u bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit. 	AS			X	X
2	Vazhdimi i procesit të akreditimit të	<ol style="list-style-type: none"> Certifkimi i Programit të Formimit Policor "Parullë e Përgjithshme", në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, përmblylja e procesit të plotësimit të dokumentacionit për tu paraqitur në grupin e Kolegjeve Policore IADLEST si autoritet certifikues. 	AS				X